



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 398/7 Prot

Tiranë, më 25.06.2021

V E N D I M

Nr.84, datë 25.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së Aktit nr. 593 datë 02.09.2020 të Kryetarit të Bashkisë, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të aktit për transferim të përkohshëm të nëpunëses *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës, protokolluar me nr. 398 prot, datë 09.03.2021, paraqitur nga nëpunësja e Bashkisë Durrës, ***** , është ngritur pretendimi se në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, pas përfundimit të afatit 6-mujor të transferimit të përkohshëm, nuk është kthyer në pozicionin e mëparshëm si “Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve” pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të kësaj bashkie.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III

“Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer verifikimi paraparak i informacionit të dërguar nga punonjësja *****, prej nga rezultoi se, ajo është nëpunëse civile e konfirmuar, në administratën e Bashkisë Durrës, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve” pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të kësaj bashkie.

Nëpunësja në fjalë, me Aktin nr. 593 datë 02.09.2020 të Kryetarit të Bashkisë, është transferuar përkohësisht, për interesa të Institucionit, në pozicionin “Inspektore e Transportit në Sektorin e Shërbimeve”, në Drejtorinë e Shërbimeve, Bashkia Durrës.

Ky urdhër është zbatuar pa kushte nga ana e nëpunëses, por më pas, megjithë përfundimin e afatit 6-mujor të këtij transferimi, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nuk është urdhëruar kthimi i saj në pozicionin e mëparshëm, ku ajo ka emërimin e rregullt. Ndërkohë, gjatë kryerjes së procesit të verifikimit të kësaj mosmarrëveshje, është konstatuar se ka patur një reagim pozitiv nga ana e institucionit dhe me Aktin nr. 45 datë 09.06.2021, të drejtuesit të Bashkisë Durrës, është urdhëruar kthimi i nëpunëses ***** në pozicionin ku ajo ka emërimin e rregullt “Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve” pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Me kryerjen e këtij veprimi nga ana e institucionit, ka rënë shkak i mosmarrëveshjes administrative lindur në këtë rast, por duke e parë çështjen nga pikëpamja e zbatimit të ligjshmërisë së menaxhimit të shërbimit civil, konstatohet se kalimi me 4 muaj, i afatit të rikthimit në pozicionin e mëparshëm të nëpunëses në fjalë, është një element i kundërligjshëm, i cili përbën shkelje të dipozitës së pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe mund të bëhet objekt i vlerësimit disiplinor, për njësinë e burimeve njerëzore.

Megjithatë, meqenëse rivendosja e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, pavarësisht vonesës, është rezultat i reagimit pozitiv të institucionit, çmojmë se është e mjaftueshme që, vërejtja e mësipërme për respektimin e afateve ligjore, të mbahet parasysht dhe të mos përsëritet në të ardhmen.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,

miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të Kërkesës nr. 398 prot, datë 09.03.2021, të nëpunëses ***** , në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të saj të përkohshëm dhe arkivimin e çështjes, duke i vënë në dukje njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të respektojë parimet dhe afatet e legjislacionit të shërbimit civil, siç është shprehur pjesa arsyetuese e këtij vendimi.

Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Durrës, Njësia Përgjegjëse dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha